

Fejtoni ynë: DRITA NR.6  
**ETNIA SUEDEZE NË FINLANDË**

Në gazetën tonë do të mund ta lexoni në formë fejtoni këtë raport, të shkruar nga Shqiptar Oseku për nevojat e Ministrisë për Informacion të Republikës së Kosovës. Etnia suedeze në Finlandë u bë objekt interesimi edhe në kontekstin e ngushtë shqiptar pas deklaratave për shtyp të Raportueses së posaçme për të drejtat e njeriut në ish-Jugosllavi zj. Elizabeth Rehn, ku u ngrit paralelja në mes të gjendjes së etnisë suedeze në Finlandë me atë të banorësisë shqiptare të Kosovës. Titujt dhe nëntitujt janë të redaksisë. Në mungesë vendi, punimit iu hoqën fusnotat.

Ky qëndrim i urtë e shpëtoi vendin për një fije nga furia e ahmarrjes së Stalinit. Në pranverën e 1945-tës filloi mësymja finale ruse, ndërkohë që edhe Britania e Madhe i kish shpallur luftë Finlandës. Mirëpo, finlandezët vetëslujues i hapën përsëri luftë kryeneçe armatave ruse, në kohën kur këto duheshin për goditjet në Gjermani. Pas disa betejave tmerrësisht të përgjakshme, Finlanda e pamposhtur arriti t'i shkëput Stalinit një ujdë të përveçme të paqes, favor ky të cilin aleatët nuk i ofruan më asnjë vendi tjetër.

Lufta e Vazhdimit përfundoi me kthimin e Karreleve në kuadër të BRSS dhe me evakuimin e popullsisë finlandeze të këtyre trevave. Finlandezët u detyruan t'i luftonin betejat e veta të fundit kundër shokëve të deridjeshëm të armëve, trupave gjermane të mbetura brenda vendit. Edhe kjo u bë pa asnjë hezitim, sërish nën komandën e gjeneralit Mannerheim, i cili që më parë i kish shkruar një letër lamtumirëse Hitlerit në të cilën i lypte falje.

Pas LDB, Finlanda e zënë me shpatulla për muri u detyrua të bënte jetë të padukshme afër fqit të vet agresiv, gjë që diplomatëve u ka dhënë shkas për termin ngapak cinik "finlandizim". Mirëpo, vendi iu ka shman-gur me këmbëngulje përfrikësimeve e fte-save kërcënuese ruse për aleancë, duke e ruajtur me smirë pavarësinë e vet.

Edhe në këtë luftë, etnia suedeze në Finlandë luajti rol jashtëzakonisht aktiv. Kry komandanti i forcave të Finlandës ishte, si e kemi cekur më parë, etnikisht suedez. Suedeze etnikë ranë nëpër të gjitha frontet e luftës duke dhënë shembuj të përmendur trimërie e vetëmohimi. Lufta e Dimrit 1939 dhe Lufta e Vazhdimit 1941-1945 i konfir-muan me gjak themelet e bashkëjetesës shekullore të të dy popujve.

**Finlanda - vend dygjuhësor**

Etnia suedeze në Finlandë përbën sot gjithsej rreth 3-6% të banorësisë së vendit varësisht prej formës së numrimit statisti-kor. Megjithatë, ajo gëzon të drejta të gjëra kushtetutare si grupacion i veçantë kombëtar në kuadër të republikës finlandeze dhe ka pozitë të theksuar në shoqëri. Partia Popullore Suedeze e përfaqëson atë në parlament, duke marrur pjesë aktivisht në të gjitha çështjet e vendit.

Statusi i veçantë i etnisë suedeze konfir-mohet, si thamë, edhe në kushtetutë dhe në ligjet tjera themelore të vendit. Neni 14 i Kushtetutës së Republikës së Finlandës përkufizon me saktësi se:

*"Finlandishja e suedishtja janë gjuhët kombëtare të republikës."*

Përpos administratës qendrore, e cila pra është dygjuhësore, secila komunë ku 10% a më tepër të banorëve kanë gjuhë tjetër am-tare fiton poashtu status zyrtar të komunës dygjuhësore. Edhe kjo pikë është konside-

DRITA NR.6  
**"Belgrad går med på medling om Kosova"**

Svensk text-TV uppgav idag att Serbien kan tänka sig att gå med på inter-nationell medling för att lösa krisen i Kosova. Utspellet kommer efter en rad sammaandrabbningar i området som lett till stor spänning och skärpt ton från USA.

AV: Shqiptar Oseku

Serbien överväger att gå med på en inter-nationell medlingsinsats för att få slut på krisen i Kosova, enligt samstämmiga uppgifter från Kosovos officiella nyhetsbyrå KIC och rapporter i svensk media. Båda anger en icke-namngiven fri radiokanal i Belgrad som källa.

Kosova var ett självstyrande område in-omramarna för forna Jugoslavien med ve-torrätt i det styrande federationsrådet. Bel-grad upphävde dock Kosovos autonomi 1990 med militär och har sen dess styrt lan-det med hjälp av undantagslagar. Den al-banska ickevåldsrörelsen trotsade intåget genom att bygga upp ett eget samhälle som vägrar lyda order från Belgrad.

**Risk för väpnad konflikt**

Uppgifter om flera blodiga attacker mot serbiska mål i Kosova avslöjar dock att si-tuationen alltmer glider mot väpnad konfli-kt i stor skala mellan serber och albaner, som hotar att dra in även grannlandet Al-banien och NATO-medlemmarna Greg-land och Turkiet.

Den oroväckande utvecklingen fick USA i sommar att öppna ett eget informations-kontor i Kosovos huvudstad Prishtina. Ett stort antal inflytelserika amerikanska poli-tiker på alla nivåer har på senare tid varit på besök i Kosova för att på plats bekanta sig med situationen.

**Motstridiga reaktioner**

I Prishtina har man alltid sagt att man vill ha en dialog med den serbiska sidan under närvaro av tredje part, underförstått USA. Nu när Belgrads hittills kompromise-lösa avvisning av allt yttre inblandning kanske håller på att uppluckras är dock re-ationerna märkvärdigt få. Från albanskt håll heter det att man f.n. undersöker allvaret i förslaget. Off the record får man dock veta att EU-land som medlare - man vill hellre ha USA i den rollen.

Det är tveldöst att Belgrad har mest att vinna på att få ingång samtalen just nu, när man fortfarande har Kosova under nå-goriunda militär kontroll och när det inter-nationella samfundet avvisar ett fritt Koso-va, för att inte riva nya sår i serbernas så-rade självkänsla. Att fördröja en fredlig lö-sning kan få ödesdigra konsekvenser. Alba-niska väpnade gerillan växer snabbt och har på senare tid utfört fler spektakulära an-fall, samtidigt som albaner får alltmer upp-backning från stormakten USA.

Icke desto mindre kan reaktionen från extremat håll bli mycket skarp. Den tra-ditionellt hårdföra serbiska kyrkan har fördömt alla samtal med albaner, medan radikaleras partiledare Tomislav Nikolic anklangde så sent som ingår USA för att stå bakom gerillaverksamheten i Kosova.

## AVTAL SPLITTRAR ICKEVÅLDSRÖRELSEN

DRITA NR.6

Överenskommelsen mellan dr.Rugova och Milosevic som syftar att reglera utbildningssituationen i Kosova får

Av Shqiptar Oseku

Utvecklingen i Kosova kan från och med september i år komma in i ett nytt skede. Den 1 september offentliggjorde den kosovariska nyhetsbyrån Kosova Info Center samt jugoslaviska Tanjug ett gemensamt uttalande från dr.Rugova och Serbiens president Milosevic som rör skolundervisningens situation i Kosova. Överaskningen var total. Nyheten om en principöverenskommelse mellan de hittills svurna fienderna i en så kontraversiell fråga briserade som en bomb och skapade feta rubriker både i Kosova och i omvärlden.

### Positiva reaktioner från omvärlden

De första internationella reaktionerna var odelat positiva. Statsdepartementet i Washington lät genom sitt informationskontor i Prishtina meddela att man från sin sida "applåderar åt framgången i förhandlingarna och tror att den kommer att staka ut vägen för en politisk och fredlig lösning av krisen i Kosova".

Inom EU i Bryssel och FN-sätet i Geneve var stämningen likaså positiv. Hans van der Broek, EU-representant som på senare tid varit involverad i det politiska spelet kring Kosova, kunde på torsdagen meddela att "man inom EU ser på lösningen av Kosovafrågan med ny tillförsikt".

I Albanien, det enda landet hittills som erkänt Republiken Kosova, kom nyheten om överenskommelsen först som en chock. De allra första reaktionerna kom från inflytelserika ledamöter i landets parlament *Kuvendi Popullor*, som uttryckte glädje över att "den albanska undervisningen i Kosova äntligen kan åter bedrivas under normala och ordnade former och i skolbyggnader". Landets president Sali Berisha sände i veckan telegram till dr.Rugova och hälsade överenskommelse, som enligt Berisha leder till att "skolarbetet i Kosova normaliseras".

Reaktionerna var i princip positiva även från oppositionens håll. Oppositionstidningarnas ledarsidor påminde dock mycket om DN:s Debattsida, då regeringen Berisha kritiserades hårt för "undanhållande av information i viktiga utrikesfrågor". Albansk TV som nu även har möjlighet att via satellit sända till den stora och politiskt viktiga albanska diasporan i Europa undvek dock sådana störande inslag och stämde in i den optimistiska vägen.

beröm av en trött omvärld men har sått djup splittring bland ickevåldsrörelsens ledande gestalter.

### Självständighetsrörelsen splittrad

Uppfattningarna om överenskommelse var dock betydligt mer delade i själva Kosova. En del politiska partier och andra associationer hälsade den och menade att dess officiella undertecknande utgör "ett bevis på Kosovos oberoende" och banar väg för "en fredlig lösning av Kosovos fråga i riktning mot de mål som folket proklamerat", dvs landets självständighet. Landets enda dagstidning på albanska Bujku och nyhetsbyrån Kosova Info Center publicerade under veckan en ström artiklar där överenskommelsen tolkades som ett första trevande steg mot fullt erkännande av Kosovos oberoende.

Den tolkningen fick sig en törn av Adem Demaçi, människorättsaktivist och Europarådets fredsprisvinnare. Demaçi för i en ovanligt skarp kritik mot dr.Rugova och etablissemanget i Kosova, vilka han menade "har visat sig mycket naiva" när de skrivit på papper som "inte förhandlar fram några krutiella och fundamentala grundvalar för en helhetslösning, utan blott rehabiliterar herr Milosevic".

Demaçis kritik fick hjälp från oväntat håll. Utbildningsöverenskommelsen mellan Rugova och Milosevic fick nämligen i veckan hård kritik även från rektorn för Universitetet i Prishtina dr.Ejup Statovci. I ett pressmeddelande på onsdagen anmärkte Statovci att albaner inte på något vis var medskyldiga till tillståndet inom skolan och att överenskommelse enligt honom felaktigt låter antyda motsatsen. Han lät förstå att varken han eller några andra intellektuella inom Universitetet varit involverade i förhandlingarna och upprepade offentligt sitt stöd för idén om ett oberoende Kosova.

Avtalet fick kritik också från akademiledamoten Rexhep Qosja, en av landets mest ansedda intellektuella röster. Enligt Qosja står den serbisk-albanska överenskommelsen på lerböter, då ingen kan garantera att man i Belgrad kommer hålla sitt ord.

"Den serbiska sidan har i Kosova alltid agerat genom lögn, utpressning och våld" sade Qosja, som tillade:

"Den albanska undervisningen i Kosova kommer aldrig att fungera normalt så länge landet är ockuperat av Serbien/Montenegro".

## NJË PASDREKE FESTIVE!

DRITA NR.6

Rapsodi Ramush Krasniqi në skenë; Çthanë suedezët për shqiptarët e Neshjes?; Talentë ka por duhet punë me ta; Për suedezë u këndua suedisht.

Shkruan: Ismail Gola

### Rapsodi Ramush Krasniqi në skenë

**B**ashkëatdhetarët tanë me qëndrim e pa qëndrim në qytetin e Neshjës të Smolandit, organizuan një program kulturor-artistik në përkujtim të 7-Shtatorit. Ishin të pranishëm pothuaj të gjithë shqiptarët me banim në këtë qytet e një pjesë edhe nga qytetet tjera përreth. Ishin të ftuar edhe miq suedezë e ndër ta edhe kryetari i "Amnesty International" për Neshjë.

Aktivitetin e organizoi një këshill i përberë prej nëntë vetash, ndërsa pjesën muzikore të programit e përgatiti aktivisti dhe rapsodi i njohur Ramush Krasniqi kurse pjesën e recitimeve poetike, mësuesja Rushe Golaj.

### Çka u tha për shqiptarët e Neshjës?

Programin e udhëhoqi Shpresa Deliu ndërsa fjalën e përshëndetëse drejtuar të pranishmëve e lexoi Nexharije Fejzu zullahu ku shkurt e qartë u soll në kujtesë rëndësia e 7-Shtatorit. Në pikën: fjala e miqve, përshëndeti kryetari i "Amnesti Internacional" i Neshjës, i cili pasi falenderoi organizatorët për ftesën, i përgëzoi shqiptarët për të cilët tha, se edhe pse larg vendlindjes, e ruajnë dhe e pasurojnë historinë dhe kulturën e tyre kombëtare. Ne, tha ai, ndo-

se jemi në vendin tonë, do ta kishim të vështirë ta organizojmë një program të këtyre përmasave. Çmojmë lartë punën tuaj, theksoi ai, dhe ju urojmë suksese të mëtejme me këtë drejtim. Në përgjithësi programi ishte i pasur në përmbajtje dhe formë.

### Talentë ka por duhet punë me ta

Shpresojmë që në mbrëmje të tjera të ardhshme festive, këshilli organizativ i kësaj komune, më bashkpunim me grupin muzikor dhe letraro-artistike si dhe me të rinjtë e të rejtat të këtij qyteti do të mund të na japin shfaqje akoma më të larmishme duke përgatitur edhe ndonjë skeç apo dramë të nivelit amator.

### Musafirët suedezë u përshëndetën me një këngë suedeze

Programi tregoi se mundësi dhe talentë për një gjë të tillë ka. Grupit organizativ i bie përgjigjësia për ti bërë dëshirat realitet.

Në grupin e recituesve të rinj e shqua për interpretim të mirë Adelina Zeqiri ndërsa më interpretimin e këngës u shqua Nazife Bego.

Miqtë suedezë i përshëndeti me një këngë vendëse, Besmira Dürmishaj shoqruar me kitarë nga Arta Póllo-shka.

Me shpejtësi fantastike njeriu hyn në orbitet e planetëve tjera:

Konvergjencat në mes përjetimeve digitale dhe atyre analoge tanimë janë shumë të dukshme. Edhe pse kjo duket paksa banale, e ardhmja kibernetike shihet edhe më qartë kur njeriu me të vërtetë në çdo aspekt e jeton kohën e vet. Kështu, demonstrimi i mundësive të shndërron në një krijesë mitologjike që ka krahët e erës, që pa pengesa shetiten anë e kënd botës, por edhe përtej saj. Pra, me një shpejtësi fantastike njeriu kalon në kohë të pakohë, hyn në orbitet e planetëve tjera, në gjithësi, në për yjësitë e pafundme, deri tek fronët e perëndive! Mundësi këto të panumërta, më shumë se sa kërkon vet imagjinata e njeriut. Ndaj nuk ka dyshim se e ardhmja digitale së shpejti do të jetë karakteristikë e përditsh - mërisë sonë.

Lufta e përgjakshme për dominim

Gjenitë e teknologjisë elektronike tanimë kanë filluar dhe po zhvillojnë një betejë të rëndë për arritjen e objektivave. Betejë kjo, e cila nuk ka sesi të definohet ndryshe pos luftë për arritjen e standardeve. Dhe mu ky objektiv është njëri nga dimensionet e epokës digitale. Kjo, në pamje të parë, duket paksa e çuditëshme, por çdo përpjekje ka konsekuencat konkrete. Nuk ka dyshim se në universin e paskajshëm elektronik zhvillohet një luftë e ashpër për dominim, por që kjo tani bëhet pa gjakderdhje. Kjo formë e luftës paqesore sot ka zëvendësuar luftërat e përgjakshme për hegjemoni dhe dominim. Për dallim nga arma e dikurshme vrastare, me anën e propa-

**DRITA NR.6**

gandës dhe reklamës, sot këtë funksion po e kryen multimedia përmes internetit, që përmes një konkurrence të ashpër progresive, po i vë në sprovë aftësitë njerëzore. Kështu, edhe në epokën e digitalizimit të jetës, "forca" dhe "teknika" - si emërtime të shprehjes klasike - dituria dhe teknologjia, por jo egërsia dhe forca ushtarake, po vendosin për gjërat dhe pozitën dominante. Pra, nuk është numri i ushtarëve, por niveli i lartë i teknologjisë elektronike që disa vende të vogëla i ka shëndrruar në supërfuqi botërore, me synime reale edhe për kolonizimin e planetëve tjera.

E tashmja primitive dhe qesharake

E parë nga hapësira kohore, posa të futesh në universin elektronik do të të duket fare normale kur para syve të shfaqet një botë krejtësisht e ndryshme nga ajo që e njohim deri sot. Mirë se vini në botën time, unë jam e ardhmja Juaj, do të të përgjigjet zëri i "udhërrefyesit". Dhe askush nuk mundohet ta fsheh se paraqitja e udhërrefyesit, ndërsa njeriu ndeshët me bombardime përshtypjesh që të vinë nga të gjitha anët, në radhë të parë ka qëllim komercial, por që pashmangshen shkon në shërbim të njeriut dhe të progresit. Kështu, e parë nga këndi racional kohor, nga pozita e njeriut modern që e jeton epokën e vërtetë digitale, e tashmja të duket jo vetëm primitive, por edhe qesharake.

Varësisht nga interesi, gjatë lundrimit nëpër hapësirën e pafundme të universit elektronik, njeriu hasë në të papritura e gjëra befasuse që gjithsesi të zgjojnë kureshtjen.

-vijon në numrin e ardhshëm-

**DRITA NR.6**

**DOKUMENTE**

Milloseviqi do të mbetet në kujtesën e kombit shqiptar si prijësi më gjakatar antishqiptar: me tanksa e hoqi autonominë e Kosovës; i helmoi 7.000 fëmijë; i mbylli shkollat, Universitetin e Radio-Televizionin; i nxorri nga puna 130 mijë punëtorë; afro 400 mijë shqiptarë nga dhuna mërguan nëpër botë.

Këto ditë, nga presioni i fuqishëm amerikano-gjerman, po ky prijës serb, u detyrua të bëjë një ndryshim kozmetik në politikën e tij, duke pranuar që së bashku me dr. Ibrahim Rugovën ta nënshkruaj një Marrëveshje me të cilën do të lirohen objektet tona shkollore, të cilat si askund në botë, ruheshin me polici. Redaksisë sonë i arriti kjo:

02-SEP '96 (LUN) 14:20 REPUBLIQUE DE KOSOVE

FAX: 0041 22 700 500

FROM: LIDHJA DEMOKRATIKE E KOSOVES PHONE NO.: + 381 38 27 660

SEK. 1

**DEKLARATË**

Tash disa vjet mbarë sistemi edukativo-arsimor në Kosovë prej atij fillor deri në atë univeritar nuk funksionon normalisht.

Në bazë të Marrëveshjes së përbashkët, të nënshkruarit më poshtë, kryetar i Republikës së Serbisë Slobodan Milloseviq dhe dr. Ibrahim Rugova arritën Marrëveshjen për të filluar normalizimin e sistemit edukativo-arsimor për nxënësit, për studentët dhe për të mësuesit në Kosovë.

Kjo Marrëveshje parashihet kthimin e nxënësve, të studentëve dhe të arsimtarëve në shkollat e në universitet.

Për arsye të rëndësishme shoqërore dhe humanitare, kjo Marrëveshje është jashtë çdo debati politik. Kujdesi për ardhmërinë e nxënësve dhe të studentëve që ndiejnë në shkollat e në universitet ata për të nënshkruar këtë Marrëveshje.

Ata, po ashtu, i falënderojnë miqtë e përbashkët nga Komuniteti Shën Exhio për ndihmën dhe për përkrahjen që dhanë për realizimin e këtyre negociatave.

Nënshkruarit janë të bindur për gatishmërinë e të gjithëve që janë të obliguar të zbatojnë Marrëveshjen për normalizimin e sistemit edukativo-arsimor. Për realizimin e kësaj Marrëveshjeje do të formohet grupi i përbashkët (3+3).

Duke lu qatur me seriozitet ngritjes së tyre arsimore dhe kulturore, të rinjtë nën qytetarë përgjegjës, kështu fiton qytetërimi, e jo njëra palë mbi tjetrën.

Prishtinë, më 01.09.1996

Beograd, më 01.09.1996

Dr. Ibrahim Rugova

Kryetari i Republikës së Serbisë  
Slobodan Milloseviq

# DOKUMENTE

DRITA NR.6



UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
UNIVERSITAS STUDIORUM PRISHTINIENSIS

TEL&FAX:++381 38 20 185

Deklarata e Rektorit të Universitetit të Prishtinës, prof.dr.Ejup Statovci

Deklaratë

Çështja e lokaleve të Universitetit të Prishtinës është e njohur për të gjitha, tash e gjashtë vjet. Ato janë objekte tona, janë prunat e Universitetit dhe e këtij populli. Ato nuk janë çështje humane ose e zemërgjerësisë së okupatorit ose e kësaj tjetër.

Nga ndërtesat nxënësit, studentët e mësimdhënësit nuk kanë dalur vullnetarisht as si akt i bojkotimit, por kanë qenë të detyruar të dalin si akt i largimit me dhunë nga regjimi serb për çështje politike. Çështja e liritë të objekteve, nuk është çështje e meshurës solidare e humane, por e drejtë legjitime e pajetërsueshme e popullit - e nxënëscve dhe studentëve. Kjo është një çështje e ndieshme dhe tejet delikate.

Për këto gjashtë vjet, respektivisht pesë vjet për Universitetin, arsimit shqip me plotë vetëdije bëri sakrificë të paparë, e rezistoi okupimin me diqitet e pa u lëkundur, krijoi identitetin dhe individualitetin e vet, e krijoi pavarësinë e vet dhe ai është bartës i pavarësisë kombëtare dhe bartës i zbatimit në praktikë të Kushtetutës së Kosovës dhe të pavarësisë së shpallur, arsimit bën një histori madhore.

Prandaj, "këhimi" nëpër lokalet e hapësirat universitare e shkollore nuk është një çështje e thjeshtë teknike, por as thjeshtë humane dhe as vetëm çështje e të drejtave të njeriut, por është çështje dhe e drejtë thelbësisht kombëtare e politike. Mbi këtë bazë, liritë i lokaleve ka kuptimin e vet vetëm në qoftë se vërtet bëhet pa kushte, në qoftë se ajo ecën në drejtim tani më të përcaktuar dhe jo për t'u integruar në sistemin e juridiksionit të okupatorit.

Arsimi universitar, Universiteti, por edhe arsimit përgjithësisht pretendon të integrohet: si i pavarur në sistemin evropian e botëror, dhe jo të ngulferet më në atë ballkanik e në të kaluarën. Nga Marrëveshja e emetuar dhe si dokument zyrtar nuk shihet konkretisht se si do të bëhet liritë, e jo këhimi, liritë pa kusht i ndërtesave dhe i hapësirës dhe deri kur do të lirohen ato. Në tekstin e botuar shqip dhe serbisht, madje ka pika dallimi, nga kjo edhe dalin ca 'hun' Në tekstin original cirilik të dokumentit zyrtar studentët nuk përmenden fare, natyrisht: as Universiteti!

Ne, në Universitet, tash për tash vazhdojmë punën tonë, madje, me intensitet të shtuar. Koha do të tregojë se si e tërë kjo do të duket konkretisht në praktikë.

Prishtinë, më 01.09.1996.



Prof. Dr. Ejup Statovci

Rektori i Universitetit të Prishtinës

historike e karakterizon dinamika në zhvillimin e ngjarjes. Njeriu sot me të drejtë mrekullohet nga arritjet e veta teknologjike. Por kjo nuk mund të jetë aspak më fascinante sesa kur shtërgjyshi ynë primitiv rastësisht e zbuloi metalin, të cilit pastaj sipas nevojës filloi t'ia japë formën për të krijuar heshta për gjah dhe vegla pune, për të arritur, ndërkaq, jo vetëm në njohjen e botës së vet, por edhe në zbulimin apo krijimin e botërave të tjera. Mëgjithkëtë, ende gjenden asi trashamanësh teknoskeptikë që fare nuk e dinë se ekziston hapësira e pafundme e botës elektronike, se lere më të futen në te.

### Lidhjet elektronike fillojnë, mbarojnë deri në pafundësi:

Për shumë kënd ajo është një botë po aq abstrakte sa edhe vetë bota jonë, në të cilën lindim si krijesa të pandërgjegjshme, amortizohemi përjetësisht përmes gëzimeve e hidhërimeve të saj dhe, sakaq, nuk jemi më. Shuarja e jetës, pas së cilës na mbetet vetëm hija e kujtesës, është një akt po aq i thjeshtë sa edhe akti i shkyqjes së lidhjes telefonike, e cila për një kohë të caktuar gjallërisht na ka mbajtur të lidhur me botën elektronike. Kështu, fillimi dhe mbarimi i jetës së gjatë tokësore i ngjan aktit të kyqjes dhe shkyqjes së lidhjes telefonike. Për dallim nga lidhjet nervore, që kanë vetëm një fillim dhe një mbarim, lidhjet elektronike fillojnë, mbarojnë dhe prapë fillojnë deri në pafundësi: Jetëra të panumërta në një të vetme, në kohë të njëjtte, por në hapësira të ndryshme. Është paradoksale, që, ndërsa krijon imazhir real të jetës kibernetike, e tërë jeta tokësore të përmbledhet në një ditë

### DRITA NR.6

të vetme sintetike. Kështu, në saje të mundësive fantastike që janë hapur për njerëzimin, ndërsa shndërrohesh në pjestar të shoqërisë së ardhshme, jeta tokësore të duket më pak e komplikuar, apo e pavlerë fare, kur asaj i shpërthehen margjinat absurde të vendosura nga injoranca njerzore.

### Njëra nga të arriturat më të mëdha të njerëzimit:

Rrjeti universal, Interneti, apo bota kibernetike që e ka krijuar teknologjia, është aq fundamentale, e ndryshme dhe revolucionare, sikur ajo të ekzistonte që nga koha kur u zbulua se bota vërtetë është e rrumbullakët, të cilës nuk i dihet as fillimi e as mbarimi. Prandaj, kjo është njëra nga të arriturat më të mëdha që ka realizuar njerëzimi që nga koha e Gutenbergut. Bota njerzore, jo ajo klasikja e shkronjave të shtypura, por kjo e pëdukëshmja, e cila nuk preket por shijohet, nga e cila jemi të rrethuar në mënyrë misterioze, vërtetë është interesante, por po aq abstrakte për ta kuptuar. Demonstrimi i mundësive të shpie në pafundësi. Mjafton ta posedosh "dritaren magjike" dhe dy tela metalik. Ashtu sikurse anija kozmike shërben për ta shpërthyer atmosferën e tokës e për të depërtuar në gjithësi, përmes një rruge të ngushtë elektrike, magjistralës elektronike, lidhjet komunikative të shpiejnë në kosmosin kibernetik.

Pothuajse çdo njëri nga ne nëpërmjet ekranit televiziv ka përjetuar udhëtimin me satelit përmes valëve elektromagnetike nga njëri skaj i botës një tjetrin. Por, përjetimi i spektorit pasiv nuk është i njëjtë sikurse përjetimi i udhëtarit interaktiv, kështu që nuk duhet të jemi aspak skeptik.



DRITA NR.6

# UDHËTIME DIGITALE

*Ecja nëpër terr, ecja nëpër shekuj; Gjenerata e epokës digitale; Trashamanët teknoskopik; Lidhjet elektronike fillojnë, mbarojnë deri në pafundësi; Njëra nga të arriturat më të mëdha të njerëzimit; Me shpejtësi fantastike njeriu hyn në orbitet e planeve tjera; Lufta për arritjen e standardeve;*

Shkruar nga: Riza Nikçi

Tek e shikon dikë duke lëvizur, menjëherë të shkon mendja se aty ka jetë, ka gjallëri, ka veprim. Lëvizja është karakteristikë e jetës. Por, edhe pse nganjëherë lëvizja demonstrohet përmes disa hapave të ngathtë, megjithatë ajo është sinonim i veprimit dhe shkuarjës përpara. Kështu, çdo lloj ecjeje ka karakteristikat dhe qëllimet e veta: Ecja përpara drejtë ardhmërisë, ecja që ka një qëllim dhe synon në arritjen e një caku apo ecje të atilla që duken të kota fare, që duket se nuk kanë asnjë synim, sorollatje të kota - atëherë kur njeriu shkon vërdallë rreth vetvetës.

### Ecja nëpër terr, ecja nëpër shekuj;

Por çka kur njeriu qëndron në vend, atëherë kur duket fare i ngurtëzuar, e megjithatë ndodhet në lëvizje, në veprim? Njeriu eci gjithmonë, ecën edhe sot, do të ecë edhe nesër. Ai vetëm ecën, ecën, ecën... Ecje nëpër terr, ecje nëpër dritë, ecje nëpër shekuj, për të hyrë më në fund nëpër labirintet e kohës, rrugët e saj zig-zake. Atyre rrugëve të pambarim, që duken si rrjeta marimangash. Por që, tek i përshkon ato rrugë, megjithë lëvizjet e shkathëta që bëjnë, fizikisht njeriu qëndron në vend, statik e i ngurtëzuar.

Dhe, kjo nuk është ndonjë mrekulli hyjnishe, por një realizim i kohës që njeriu e bëri për vetvetën gjatë ecjes së tij të gjatë. Të arriturat e sotme teknologjike gjithsesi janë krenaria e gjeneratës së kohës sonë. Është e ditur, ndërkaq, se secila gjeneratë ka kohën e vet, të cilën me mburrje e quan kohë moderne. Por, për ta vendosur atë në periudhë të caktuar historike, duhet të përcaktohet koha në kohë, që nganjëherë ecën me shpejtësi marramendëse, sikurse kjo e tashmja. Kështu, gjenerata e këtij fund-mileniumi, me hapat gjigantë që po bëjnë në histori, padyshim se do të quhet gjenerata e epokës digitale, apo e fillimit të hershëm të epokës digitale, e cila për kohë dhe hapësirë kaq të shkurtë dallon aq shumë nga paraardhësi i vet, i cili kultivonte mitin e profetit në qiell, sa edhe largësia e tij nga stërgjyshi i lashtë, të cilit rrënjët ia gjejmë që para epokës së gurit. Koha pra, apo epoka, nuk matet me kut apo kohë: muaj-vite-dekada..., por me aktin historik që e përfaqëson. Ajo e ka limitin e vet, fillimin dhe mbarimin - identitetin e vet që e dallon. Ashtu sikurse një akt në skenë mund të jetë i shkurtë por shumë dramatik, kurse tjetri i ngathtë dhe i stërgjatë, edhe periudhën

# DOKUMENTE:

### *Si u prit kjo Marrëveshje ndër shqiptarë?*

*TVSH - Programi Satelitor, Dt.02.09.96 ora 18.35.*

Në Prishtinë u mbajt një konferencë shtypi ku Abdyl Ramaj, Fehmi Agani dhe Xhavit Ahmeti dhanë disa detaje mbi Marrëveshjen e nënshkruar nga kryetari Rugova dhe ai serb Millosheviq, për kthimin e shqiptarëve në objekte të tyre shkollore dhe universitare. Në fillim të konferencës me gazetarë magjister Abdyl Ramaj, Kryetar i Komisionit Parlamentar të Kosovës për Çështje të Arsimit tha se, realizimi i Marrëveshjes mbi masat e para për normalizimin dhe funksionimin e sistemit edukativo-arsimor në Kosovë do të fillojë qysh gjatë javës së ardhshme në Romë, me krijimin e grupeve të përbashkta punuese. Z.Ramaj theksoj se rëndësi të posaçme ka fakti se Marrëveshja parasheh kthimin pa kusht të nxënësve, studentëve dhe arsimtarëve shqiptarë në objekte shkollore dhe universitare, duke përfshirë dhe objektet ndihmëse siç janë: konviktet e nxënësve edhe studentëve, bibliotekat, menzat e palestrat sportive. Në vazhdim Abdyl Ramaj tha se kjo Marrëveshje parashikon kthimin e fëmijëve shqiptarë në 24 shkolla tetëvjeçare dhe në paralele të tyre të ndara... në 61 shkolla të mes me... pastaj në 13 fakultete e 7 shkolla të larta të Universitetit të Prishtinës. Po ashtu Marrëveshja parashef edhe lirim të objektit të Entit të Teksteve dhe Mjeteve Mësimore të Kosovës me gjithë pasuritë e tij si dhe funksionimin normal të gjitha institucioneve pedagogjike të Kosovës. Besojmë tha z. Ramaj se pjesa më e madhe e punës për zbatimin e kësaj Marrëveshje do të kryhet gjatë muajit shtator. Duke folur rreth financimit z. Abdyl Ramaj tha se kjo çështje është e lidhur ngusht me zgjidhjen globale të problemit të Kosovës, prandaj ka mbetur për tu shqyrtuar më vonë. Ndërkaq dr. Fehmi Agani, nënkryetar i Lidhjes Demokratike të Kosovës tha se nënshkrimi i kësaj Marrëveshje që nuk ka ngjyrim politik do të jetë ndihmesë e madhe për nxënësit shqiptarë që ta zhvillojnë mësimin me kushte më të pranueshme. Marrëveshja është e favorshme për ne dhe jam optimist se ajo do të realizohet në terësi. Grupi ynë i punës do të jetë adapt dhe konstruktiv sepse jemi të interesuar që Marrëveshja të gjej sa më parë zbatim të plot, tha Fehmi Agani. Ai tha se dy antarë të palës së tretë ndërkombëtare do të marrin pjesë në të gjitha kontakte e grupeve punuese.

### Mehmet Haziri, gazetar i TVSH:

Kryesia e LDK-së sot Marrëveshjen e nënshkruar nga presidentet e Rugova e Millosheviq për kthimin e nxënësve, studentëve e arsimtarëve në objektet e tyre shkollore dhe universitare e përshëndet si një hap të parë drejt normalizimit të sistemit edukativo-arsimor, në Kosovë. Në komunikatën për opinion theksohet që ky kthim avancohet edhe më tutje pavarësinë e shkollën shqipe ... kjo është dëshmi se rezistenca paqësore shqiptare po jep rezultatet e veta...

**DOKUMENTE:**

Nënshkrimin e Marrëveshjes për normalizimin e arsimit shqip të Kosovës e për rshëndetën edhe dy krahtë e Partisë Socialdemokrate të Kosovës: Marrëveshja paraqet rezultatin fillestar por të rëndësishëm të lëvizjez politike të Kosovës për kthimin e realizimit të drejtave të popullit shqiptar me mjete politike. Të dy krahtë e kësaj Partie vlerësojnë trajtimin e barabartë të palës shqiptare në këtë Marrëveshje dhe parashohin ndryshime të rëndësishme politike në Kosovë. Edhe në konferencën e sotme të shtypit të Partisë Liberale të Kosovës kryetari Gjergj Dedaj u tha gazetarëve se Partia e tij përshendet nënshkrimin e Marrëveshjes si hap i rëndësishëm normalizimin e sistemit mësimor në Kosovë dhe si rezultat e politikës së urtë të udhëheqjes politike të Kosovës dhe të Presidentit Rugova drejt zgjidhjes së plot të çështjes së Kosovës. Partia Liberale e Kosovës kërkon tërheqjen të gjitha forcave policore ushtarake të Serbisë nga Kosova si hap për krijimin e rrethanave normale të dialogut ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit. Edhe Partia e Unitetit Kombëtar, me seli në Prishtinë, rëndësinë dhe efektin e Marrëveshjes e lidhë me realizimin e saj sa më të shpejtë duke shfaqur njëfarë droje në korrektësinë e palës serbe.

**Presidenti i Shqipërisë, dr. Sali Berisha e përshendet Marrëveshjen:**

"Marrëveshja për arsimin e Kosovës e arritur ndërmjet presidentit Rugova dhe presidentit Millosheviq, është një hap shumë i rëndësishëm në drejtim të garantimit të plotë të lirive dhe të drejtave njerzore dhe kombëtare të shqiptarëve të Kosovës. Dua t'i përgëzoj palët nënshkruese dhe ata që ndihmuan në arritjen e kësaj Marrëveshje dhe të shpreh bindjen time se nëpërmjet dialogut dhe vullnetit të mirë mund të realizohen edhe hapa të tjerë, shumë të rëndësishëm për zgjidhjen e problemit të Kosovës"

**Marrëveshjen e përshendetën edhe partitë tjera në Viset Shqiptare nën Jugosllavi e Maqedoni si dhe Kryetari i Partisë Demokratike të Shqipërisë.**

**Radio Stokholmi, Ditari, më 05.09.96, ora 11,15**

**Adem Demaçi:**

"Fatkeqësisht unë jam i dëshpruar nga kjo eufori që po e shof tek shqiptarët e painformuar, të cilët nuk dinë se çfarë është kjo faktikisht. Ko nuk është kurrfarë normalizimi i arsimit shqip, sepse këtu është fjala vetëm për një lëshim të vogël, që e bëhet nga ana e regjimit të Beogradit, kurse problemet kyqe të arsimit shqiptar si pagesa e mësuesve, arsimtarëve, shpenzimeve tjera përcjellëllëse për krejt arsimin tonë që shkojnë me këto-nuk bëhet fjalë aspak! Dome thën, unë e konsideroj këtë letër të bërë (Marrëveshjen - vërejtje e redaksisë!) si një mashtrim shumë të madh për neve. Të them të drejtën, nuk e kam pritur, sepse unë mendoj se këtë argument, të madh, të fuqishëm, që e kemi pasur ne për shtypjen që është duke e ushtruar regjimi i Beogradit ndaj shqiptarëve në një mënyrë sikur e lëshuam nga dora dhe bota tjetër më nuk do të na besojë se arsimit është i ndaluar nga ana e serbëve....Me nënshkrimin e kësaj Marrëveshje z. Rugova taktikisht duket se ka fituar diçka, por strategjikisht ai në të vërtetë, ka hyrë në binarin e ngushtë të autonomisë, dhe nuk ka fuqi më që ta nxirr nga kjo.

**Nuk jam e shqetësuar për të ardhmen tuaj**

-A ju ka rënë të lexoni diç nga letërsia shqipe dhe ç'përshtypje keni nga kjo?

- Unë e kam lexuar veçmas "Dritën", pra poezitë e përkthyer për bukuri në gjuhën suedeze dhe, duke u nisur nga kjo, pohoj me përgjegjësi të plotë se tashmë nuk jam e shqetësuar për të ardhmen tuaj! Një popull që ka një bagazh të tillë të identitetit të vet kulturor, ai nuk mund të mbahet gjatë nën prangat e robërisë. Do të di t'i gjejë shtigjet për t'iu shmangur kurthave që hë për hë i dalin përpara në rrugëtimin e vet të gjatë e të mundimshëm drejtë synimeve të tija liri-dashëse. Për këtë jam më se e bindur.

-Në fund, a do të kishit shtuar ndonjë gjë që mua nuk më ka rënë ndërmend të iu pyes?

- Unë dëshiroj që shqiptarët ta vazhdojnë këtë traditë dhe ta kultivojnë edhe tek brezat e tyre të ardhshëm. Kjo është udha më e mirë për të arritur miq, të cilët për ju në këto çaste të rënda, u janë më se të domosdoshëm.

- Ju falenderoj në emër të redaksisë për intervistën e dhënë dhe për konsideratat që keni ndaj bashkkoombasëve tanë!

**Hajdin Abazi :**

**Zhdaravitje imazhi**

Pakufishëm më kanë lodhur

Të pakthyesmet vite

Të rinisë,

Që u dogjën

Metropoleve,

Por më shumë

Më ka rraskapitur

Zhdaravitja

Plagëshkaktuese

E imazhit tënd

SH

Q

I

P

Ë

R

I

**Lajme të shkurta nga Trelleborgu:**

*(Përgaditur nga: Frashër Oseku)*

**Gjinnazistët e parë**

Vjet, për herë të parë, në qytetin e Trelleborgut u regjistrua si gjinnazist Arbon Vata, një nxënës ambicioz. Ky e regjistroi matematikën, grup ky të cilin të gjithë e konsiderojnë të vështirë, por jo edhe Arboni. Sivjet në gjinnaz u regjistruan edhe: Nehale Jashari, Jakup Guta, Afërdita Hoxha Driton Kongjeli, Arben Hoxha, Samir Rama, Lulzim Beiqi, Samir dhe Igballe Kogjakatër

- Paçin fat!

**Ndihma për të sëmurën dhe shkollën**

Këto ditë në Shoqatën Besa të Trelleborgut u mbledhën dhe iu dërguan 2.570 korona suedeze ndihma për Shqipe Hoxhën, me banim të përkohshëm në Borlänge. Kjo vuani nga një sëmurje e tillë, e cila në bazë të propozimit mjeksor duhet mjekuar jashtë Suedisë.

Tashmë këtu është krijuar një traditë e dhënjes së ndihmave për të gjitha ato akcione që janë inicuar nga bashkatdhetarët tanë, e që kanë për qëllim shpëtimin e jetërave të mërgimtarëve. Por, ndihma janë dhënë edhe për shkollën shqipe, për minatorë etj. Kryetari i Shoqatës, Agron Gjoci, së bashku me Shaban Rashitin, arkatar, për këtë rast kanë vrapuar tre ditë rresht te secili bashkatdhetarë dhe, në sajë të solidaritetit që treguan njerëzit tanë, arritën që ta tubojë shumën e cekur më lartë.

**Sport**

Klubi futbollistik "BESA" i Trelleborgut për sezonën verore e zuri vendin e parë në garat ndërkomunale të qytetit. Kjo është një arritje e madhe sepse, klubi është formuar tek para 5-6 muajsh. Meritën më të madhe e kanë lojtarët e disiplinuar po edhe kryetari i ekipit në fjalë, Skënder Bajgora. Në periudhën e ardhshme këta sportistë i pret edhe një luftë e fortë, por si gjithnjë, shpresat janë se "BESA" nuk do të gjunjë-zohet as atëherë.

- Urojmë suksese të reja!

**Lajm i fundit** Shoqata sportive Besa e Trelleborgut u bë kampione e Ligës së Qarkut për Trelleborg.